



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2016

MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

► UDHËZUES PËR APLIKUES

PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2016



MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

*Ky dokument është përgatitur nga Autoritetit Menaxhues në bashkëpunim me
Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë*

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| 1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË | 3 |
| 1.1. Hyrje | 3 |
| 1.2. Objektivat e masës | 3 |
| 1.3. Mjetet financiare..... | 3 |
| 1.4. Përkufizimet kyçe..... | 4 |
| 2. INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINACIARE, SI DHE APLIKANTËT E PRANUESHËM | 5 |
| 2.1. Intensiteti i ndihmës..... | 5 |
| 2.2. Pranueshmëria e aplikantëve dhe aplikacioneve të tyre..... | 5 |
| 3. SHPENZIMET E PRANUESHME | 6 |
| 3.1. Shpenzimet e pranueshme / pranueshmëria e kostove | 6 |
| 4. PROCEDURAT E APLIKIMIT | 6 |
| 4.1. Përmbajta e aplikacionit | 6 |
| 4.2. Kriteret e përzgjedhjes | 7 |
| 5. DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT | 8 |
| 6. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI | 8 |
| 6.1. Vlerësimet dhe zgjedhja e aplikacioneve; Procedurat e përzgjedhjes;..... | 8 |
| 6.2. Kontrollat në terren..... | 9 |
| 6.3. Radhitja në listë..... | 9 |
| 6.4. Pagesa e Grantit..... | 9 |
| 6.5. Monitorimi Ex-post..... | 10 |
| 7. DISPOZITA TE RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTARË I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT | 10 |
| 8. LISTA E SHTOJCAVE - ANEKSE | 11 |
| 8.1. Shtojca 1 lista e dokumenteve të dorëzuara..... | 11 |
| 8.2. Shtojca 2: formulari për aplikim | 13 |
| 8.3. Shtojca 3: projekt propozimi | 15 |
| 8.4. Shtojca 4: formulari i kontratës | 15 |
| 8.5. Shtojca 5: procedurat e prokurimit..... | 19 |
| 8.6. Shtojca 6: lista e investimeve/ shpenzimeve të pranueshme..... | 22 |
| 8.7. Shtojca 7: formulari i kërkesës për pagesë për masën ujitje | 23 |
| 8.8. Shtojca 8 : letra informuese..... | 25 |
| 8.9. Shtojca 9: formulari i indikatorëve | 27 |
| 8.10. Shtojca 10: forma e ankesës..... | 28 |
| 8.11. Shtojca 11: lista me adresa të zyreve regjionale dhe kontaktet | 29 |
| 8.12. Afati i implementimit te projektit..... | 30 |

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË

1.1. HYRJE

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, dhe ky zhvillim nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore, si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes. Derisa në stinët tjera të rreshurat janë të mjaftueshme, gjatë stinës së verës ato mungojnë. Prandaj, imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendat, rezervuarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat, etj. kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja, si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intenzive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit.

1.2. OBJEKTIVAT E MASËS

Objekti i kësaj mase është rritja e produktivitetit përmes rritjes së rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore duke përdorur ujitjen e kulturave bujqësore përmes investimeve në:

Rritjen e siperfaqeve të tokës bujqësore nën ujitje

Modernizimin e sistemit të ujitjes dhe drenazha duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit dhe përmirësimin e prodhimit të energjisë elektrike.

Përmirësimin e lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes

1.3. MJETET FINACIARE

Për këtë masë për vitin 2016 janë ndarë gjithsej: 1.000,000 €

1.4. PËRKUFIZIMET KYÇE

Intensiteti i ndihmës – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme

Aplikantë – janë personat fizik ose personat juridik që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të prezantuara në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grantet e zhvillimit rural;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë;

Përfitues – personi fizik ose personi juridik i cili është deklaruar përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë;

Thirrja për aplikim – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;

Kontrata – nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikantit të përzgjedhur dhe Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë sipas modelit të përgatitur, shih Shtojcën nr. 8.4

Shpenzimet apo investimet e pranueshme – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike, shih Shtojcën nr. 8.6

Periudha e monitorimit Ex-post – periudha kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet ruaj qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;

Grant – ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;

Autoriteti Menaxhues – entitet publik brenda MBPZHR i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;

Masa – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjencion i Pagesave (www.azhb-ks.net) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve, si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2016 – është dokument teknik i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;

Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikanti;

Periudha e implementimit të projektit – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB-ja;

Përzgjedhja – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikantët e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre „i përzgjedhur për financim“ dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

2. PËRKRAHJA PUBLIKE DHE APLIKUESIT E PRANUESHËM

2.1. PËRKRAHJA PUBLIKE

Përkrahja publike është 80 % e shpenzimeve të pranueshme.

Kujdes: TVSH-ja është shpenzimi i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhet nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa!

2.2. PRANUESHMËRIA E APLIKANTËVE DHE APLIKACIONEVE TË TYRE

Aplikantët për këtë masë janë:

- ▶ Fermerët, sipas definicionit nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (L-03/098) dhe ndërmarrjet e tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave.
- ▶ Shoqatat e përdoruesëve të ujit.

Të gjithë këta i nënshtrohen kontrollit të pranueshmërisë. Nëse konstatohet se aplikanti është i papranueshëm, aplikacioni refuzohet. Pranueshmëria e aplikantit kontrollohet në bazë të dokumenteve të kërkuara dhe atyre të dorëzuara.

Një aplikant mund të dorëzojë vetëm një projekt brenda vitit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë Aplikacionin mbështetur me të gjitha dokumentet e kërkuara - shih Aneksin 8.1.

Aplikanti duhet të nënshkruaj një deklaratë që deklaron se ai/ajo nuk do të ndryshojë qëllimin e investimit për të paktën pesë vjet pas realizimit të investimit.

Personat juridik/përfituesit duhet gjithashtu të mbajnë investimet në kushte të përshtatshëm. Aplikantët nuk duhet të kenë detyrime të papaguara ndaj shtetit për sa i përket detyrimeve fiskale (taksat e ATK-së për personat juridik) dhe nuk duhet të kenë obligime të pakryera financiare ndaj MBPZHR-së në bazë të marrëveshjeve kontraktuale.

Kujdes: është e rëndësishme që taksat të paguhet gjatë zbatimit të Projektit dhe në periudhën e monitorimit Ex-post (5 vjet pas zbatimit të projektit). Përfituesit të cilët do të gjenden me taksat të papaguara gjatë afateve të përmendura, do të jenë të detyruar për të paguar të gjithë grantin e pranuar, plus ndëshkimet e aplikueshme.

Personat fizik që aplikojnë me vlerë të projektit më të madhe se 50,000 euro duhet të rexhistrohen si biznes ose si shoqatë.

Aplikanti duhet të paraqes një projekt - propozim sipas modelit të kërkuar. Vlera e investimit minimal në kuadër të kësaj mase është 20,000 euro dhe maksimalja e investimeve të pranueshme është 200,000 euro.

Në rast se vlera e shpenzimeve të pranueshme është më e madhe se 100,000 €, pagesa bëhet në dy këste. Pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Formulari i Treguesëve duhet të plotësohet në mënyrë të drejtë.

Shih Shtojcen 8.10

Në rast të projektit të ndërtimit apo rindërtimit, Aplikanti duhet të paraqes edhe dokumentet në vazhdim:

- › Kopja e skicave/dizajneve dhe vlerësimin e shpenzimeve për punën;
- › Vlerësimin ndikimit në mjedis (nëse parashihet ligji);
- › Përgatitja e dokumenteve të aplikimit;
- › Të sillet projekti me dizajnim dhe paramasë pasi të nëshkruhet kontrata.

Në rast të përzgjedhjes së projektit, para nënshkrimit të kontratës, përfituesi duhet të dorëzojë:

- › Projektin e detajuar, me paramasë dhe paralogari;
- › Pëlqimin nga komuniteti, nëse parashihet me ligj;
- › Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me ligj;
- › Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës.

Kujdes: Vendet e reja të deklaruara të punës duhet të regjistrohen, dhe taksat e tyre duhet të paguhen sipas ligjeve në fuqi!

3. SHPENZIMET E PRANUESHME

3.1. SHPENZIMET E PRANUESHME / PRANUESHMËRIA E KOSTOVE

| |
|--|
| 1.1. Rehabilitimi dhe vazhdimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes; |
| 1.2. Ndërtimi i rezervoarëve të ujit; |
| 1.3. Penda e ujitjes; |
| 1.4. Ndërtimi i drenazhës/kullimit; |
| 1.5. Pompat e ujitjes dhe pajisjet e tjera përcjellese:(pajisje për matjen e ujit, për rrymë, etj); |
| 1.6. Rehabilitimi i pajisjeve (valvulat, lidhëset, gypat, përfshirë edhe punën) |
| 1.7. Punët përcjellese me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit). |
| 1.8. Shpenzimet që janë të lidhura me përgatitjet e projektit janë të pranueshme 3% të vleres ndërsa 7 % të shpenzimeve janë të pranueshme për |
| 1.9. Skicat/dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik |
| 1.10. Vlerësimi i ndikimit mjedisor |
| 1.11. Përgatitja e dokumenteve të aplikimit. |
| 1.12. Hapja e puseve me kushtë që pusi të ketë ujë |

Këto shpenzime janë të pranueshme në mënyrë retroaktive vetëm për përfituesit përfundimtarë.

4. PROCEDURAT E APLIKIMIT

4.1. PËRMBAJTA E APLIKACIONIT

Kujdes: për të qenë i pranueshëm aplikacioni duhet të përmbajë të gjitha dokumentet e radhitura në listën e paraqitur në Shtojcën nr. 8.2

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtareve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të shkruaj në kopje këtë tekst: "si në origjinal", dhe ta nënshkruaj.

Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e kopjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD, e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruaj për nevoja personale.

Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim, që të kenë mundësi të kompletojnë dokumentacionin e tyre në rast të mungesës së ndonjë dokumenti.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrat regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë.

4.2. KRITERET E PËRZGJEDHJES

| Kriteri | Parametri | Nr. i pikëve |
|---|--|----------------|
| Kostot-efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura | <p>Metoda e kalkulimit: Të gjitha projektet teknike duhet të përfshijnë të dhëna në lidhje me zonën që është ndërtuar/rehabilituar/zgjeruar për ujitje dhe koston mesatare për ha. Pasi të jenë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove/ ha, duke filluar nga më e ulëta deri tek më e larta. Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për hektar do të marrin 0 (zero) pikë. Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriterinë bazë të koston së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p>Kalkulimi për poentim: $20 * (C_p - \max C) / (\min C - \max C)$ Cp - kosto për 1 ekstra ose ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e vlerësuara Shpenzime minimale C kosto për 1 ekstra ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto minimale për ekstra ose ha të modernizuar të ujitur – Maksimale C- kosto për 1 ekstra ose modernizim ha të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto maksimale për ekstra ose modernizim ha të ujitur</p> | Max. 30 |
| Sipërfaqja e ujitur (ha) | ≥ 20 - < 50 ha | 10 |
| | ≥ 50 - < 75 ha | 15 |
| | ≥ 75 - < 100 ha | 20 |
| | ≥ 100ha | 30 |

| Aplikuesi është shoqatë për ujitje të tokave bujqësore | | 10 |
|--|---------------|------------|
| Numri i fermerëve të regjistruar në Regjistrin e Fermës që përfitojnë nga projekti | 1-10 | 10 |
| | 11-20 | 15 |
| | 21 e më shumë | 20 |
| Realizimi i projektit përfshinë përfitues të Masës 101" Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore" në tri vitet e fundit. | 1- 5 | 5 |
| | 6 e më shumë | 10 |
| Totali | | 100 |

5. DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 40 ditë nga data e shpalljes së thirrjes publike për aplikim. Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara - shih shtojcen Nr 1. duhen të dorëzohen brenda periudhës së përmendur në shpallje. Nëse Aplikacioni nuk është i plotë, ai do të refuzohet menjëherë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyret Regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë.

6. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI

6.1. VLERËSIMET DHE ZGJEDHJA E APLIKACIONEVE; PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES;

Procedura e përzgjedhjes do të bazohet në një sistem të renditjes së kritereve të përzgjedhjes, e cila do të zhvillohet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë, si pjesë e thirrjes publike për aplikim për përzgjedhjen e masës së ujitjes!

Projekti teknik i dorëzuar duhet të demonstroj zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 10% në rast modernizimi.

Punëkryesi duhet të garantoj dhe të mirëmbaj ose të bëj riparimin e infrastrukturës bujqësore të paktën 3 vjet pas zbatimit të projektit dhe të jetë nën kontrollin e Agjencisë të për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Departamentit të PBT së MPBRZH. Nëse nuk është bërë mirëmbajtja gjatë kësaj periudhe, atëherë përfituesi duhet të kthej prapa investimin.

Vetem në rast të fatëkeqësive natyrore, atëherë duhet të formohet një komision nga AZHB dhe MBPZHR dhe me raportin e komisionit konstatohet se prishja e projektit është bërë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, atëherë punëkrysi nuk ka obligim të garantoj punën që e ka kryer sipas kontratës.

Për kryerjen e punimeve për projektin duhet të kontraktohet ndërtuesi i cili ka përvojë të mëhershme në ndërtimet relevante që kërkohen, dhe i cili do të garantoj për punën e ndërtimit

për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës. Ndërtuesi i kontraktuar duhet të dëshmojë fitimin e ndermarrjes së tij për tre vitet e fundit dhe respektimin e rregullave të legjislacionit nacional të prokurimit.

Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratën me shkrim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit.

Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë: 20 ha.

Aplikuesi duhet të dëshmojë të drejtat pronësore lidhur me investimin e propozuar.

Nje kompani e ujitjes, Shoqata e përdoruesve të ujit dhe Fermeri si person fizik ose juridik mund të aplikoj maksimumi 1 projekt brenda një viti.

Aplikantët do të paraqesin vendimin pozitiv të Bordit gjatë propozimit të investimit ku do të sigurohet 20% nga përfituesi.

Vlerësimi i projekteve dhe kontrollat në terren do të bëhen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe nga departamenti i PBT së MPBRZH para dhe pas nënshkrimit të kontratës. Kosto minimale e investimit të pranueshëm për projekt është 20,000 €.

6.2. KONTROLLAT NË TERREN

Së paku janë 3 kontrole të parapara në terren: para së të nënshkruhet Kontrata, para se të deklarohet Pagesa për t'u bërë AZHB është e obliguar që ta marr një ekspert të Hidro-inxhinjer që në mënyrë të bëhet vlerësimi i projektit sa më i saktë, deri 3 vjet pas implementimit të Projektit – gjatë Periudhës të Monitorimit ex-post të Projektit.

Kujdes: Kur ka kërkesë për kontrollë, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në investimet e bëra, kjo vlen po ashtu edhe nëse kërkohet ndonjë dokument shtesë nga Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mos respektimi i këtij kushti duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i grantit dhe ndëshkimi i aplikuesit!

6.3. RADHITJA NË LISTË

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhitën në listë në bazë të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit.. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit.

Pas vlerësimit, AZHB përgatitë Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë dhe 2) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë). Raporti preliminar nënshkruhet nga kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në web faqe të AZHB-së dhe web faqe të MBPZHR. Të pakënaqurit kanë afat 15 ditë nga dita e publikimit të vijnë në AZHB dhe të informohen për detajet e vlerësimit dhe të marrin letrën e informuese me sqarimet rreth vlerësimit ose vendimit.

Prej ditës së pranimit të Letrës Informuese, aplikuesi ka afat 15 ditë të ushtrorë ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Ankesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e letrës informuese dhe nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër.

Komisioni i Ankesave merr vendim brenda 30 ditësh.

Aplikantët e përzgjedhur ftohen të nënshkruajnë kontratën, sipas modelit në shtojcë, me AZHB-në në Prishtinë, më së largu 20 ditë pas publikimit të Raportit Përfundimtar të Përzg-

jedhjes. Të gjitha postimet e rezultateve të vlerësimit në web-faqen e AZHB-së duhet të rrinë aty së paku dy vjet.

6.4. PAGESA E GRANTIT

Në rast se vlera e shpenzimeve të pranueshme është më e madhe se 100,000 €, pagesa bëhet në dy këste. Pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500-euro duhet të bëhen përmes transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500-euro duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

KONTRATA MES PËRFITUESIT DHE AZHB-SË, BASHKË ME PROCEDURAT E PROKURIMIT

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde – shih shtojcën më poshtë. Lista e përfituesve që nënshkruajnë kontratë do të publikohet nga AZHB-ja.

Plani i biznesit ose projekt propozimit së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 5 vjet pas implementimit të projektit.

(Nëse brenda periudhës 5 vjecare përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR, duhet të behet një kontrollë para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB, në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm a është funksional. Kjo vjen si rrjedhojë e (Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesi) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 5 vjet pas zbatimit të projektit).

Periudha e përfundimit të projektit nënkupton përfundimin e investimit. Kontrata e mbulon edhe periudhën e monitorimit.

6.5. MONITORIMI EX-POST

Të gjitha projektet do të monitorohen 5 vite pas Implementimit të Projektit, kontrollimi do të bëhet nga Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 5 vjet pas investimit. Gjithashtu, përfituesit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat Aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

7. DISPOZITA TE RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTARË I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT

Aplikacionet mund të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nëse nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose edhe kur e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë mund të refuzohen për shkak të numrit të vogël të pikëve.

Kujdes: arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në letrën informuese të cilën Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë ia dërgon aplikuesit.

1. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i AZHB-së me rastin e dorëzimit të tyre. Në rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai po ashtu refuzohet.
2. Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollës administrative (psh., mospërputhje me të dhënat apo vlerësime të dokumenteve ose gjatë kontrollës në terren. Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

Kujdes: për aplikacionet e pakompletuara, aplikanti njoftohet menjëherë. Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme, por me numër të vogël të pikëve janë pjesë e Raportit të Vlerësimit, të cilin Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë e publikon në ueb-faqen zyrtare (www.azhb-ks.net) jo më vonë se 24 orë pasi që lista e aplikanteve është e përfunduar dhe nënshkruar nga shefi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikantët duhet të njoftohen me shkrim me rezultatin e vlerësimit më së largu pesë ditë pas shpalljes së listes në webfaqe.

8. LISTA E SHTOJCAVE

- 8.1. SHTOJCA 1: LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA;
- 8.2. SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM;
- 8.3. SHTOJCA 3: PROJEKT PROPOZIMI;
- 8.4. SHTOJCA 4: FORMULARI I KONTRATËS;
- 8.5. SHTOJCA 5: PROCEDURAT E PROKURIMIT;
- 8.6. SHTOJCA 6: LISTA E INVESTIMEVE/ SHPENZIMEVE TË PRANUESHËM;
- 8.7. SHTOJCA 7: FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË PËR MASËN UJITJES;
- 8.8. SHTOJCA 8: LETRA INFORMUESE;
- 8.9. SHTOJCA 9: FORMULARI I INDIKATORËVE;
- 8.10. SHTOJCA 10: FORMA E ANKESËS;
- 8.11. SHTOJCA 11: LISTA ME ADRESA TË ZYREVE REGJIONALE DHE KONTAKT DETALET;
- 8.12. SHTOJCA 12: AFATI PËR IMPLEMENTIM TË PROJEKTIT

8.1. SHTOJCA 1 LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet të ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që të një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja të veta.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikantin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ja rrumbullakësuar dokumentet që i mungojnë. Aplikanti ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletoj dokumentet.

Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikanti e shkruan me dorë në kopje „**sikur në origjinal**“ dhe ja sjellë origjinalin në shikim zyrtarit regjional i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ja kthen origjinalin aplikantit

| Nr. | Dokumenti | Obligativ | opcional |
|-----|---|--------------------------------|----------|
| 1. | Kopja e leternjoftimit te aplikuesit. Ne raste te personave juridik kopja e leternjoftimit te menaxherit,te pronarit ose te personit te autorizuar te ndermarrjes | | |
| 2. | FORMULARI PËR APLIKIM Sipas modelit te AZHB-se i plotësuar me makine ose kompjuter (nuk lejohet dorëshkrimi) Kontrolli nëse dokumentet janë te mbushura si duhet të bëhet në momentin e dorëzimit në prani të aplikantit | f. <input type="checkbox"/> | |
| 3. | NIF (numri identifikues i fermerit- farm regjister) | f. | |
| 4. | FORMULARI PËR INDIKATOR i plotësuar (në original, nuk lejohet dorëshkrimi) Në prani të aplikantit zyrtari verifikon a është plotësuar si duhet formulari për indikatorët. | f. <input type="checkbox"/> | |
| 5. | LLOGARIA RRJEDHËSE , dokument i lëshuar dhe vulosur nga banka (në origjinal) Llogaria rrjedhëse duhet të jetë nga një bankë që operon në Kosovë | f. <input type="checkbox"/> | |
| 6. | Në rastin e personave juridik: CERTIFIKATA E NUMRIT TE BIZNESIT CERTIFIKATA E NUMRIT FISKAL – kopje | f. <input type="checkbox"/> | |
| 7. | PROJEKTI TEKNIK (me llogaritje për të zvogëluar sasinë e ujit që humbet në rast të projekteve për modernizim dhe projektimet relevante)-në original. Aplikuesit duhet të paraqesin projektin detaj, me dizajnim, para masë dhe para llogari. | f. <input type="checkbox"/> | |
| 8. | Projekt – Propozimi Përgatitja e projekt propozimit teknik të detajuar bëhet nga ana e aplikuesit | f. <input type="checkbox"/> | |
| 9. | Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënjes së grantit, aplikuesi mund të marr leje ndërtimi | f. <input type="checkbox"/> | |
| 10. | Në rast të përfitimit të projektit duhet të sjellin: Pëlqimin nga komuniteti, nësëeparashihet me ligj; Vlerësimin e ndikimit nëmjedis, nëse parashihet me ligj; | f. <input type="checkbox"/> | |
| 11. | Lista e fermerëve që përfitojnë nga sistemi i ujitjes së propozuar që të ndërtohet/modernizohet/zgjerohet bashkë me NIF e tyre (nga Regjistri i Fermës) | f. <input type="checkbox"/> | |
| 12. | Për personat juridik: VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikanti nuk ka obligime të papaguara (në origjinal) | f. <input type="checkbox"/> | |
| 13. | AUTORIZIMI- Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri. | f. <input type="checkbox"/> | |
| 14. | DOKUMENTI QË DËSHMON PRONËSINË MBI TOKËN (kopja e planit dhe fleta poseduse ku do të kryhet investimi) | f. <input type="checkbox"/> | |
| 15. | Deklarata me shkrim përmes se ciles garanton se do të participojë me 20% të vlerës për realizimin e projektit | | |

8.2. SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM

FORMULARI PËR APLIKIM

MASA Ujitja e tokave bujqësore – 2016

| | | |
|---|--|---|
| I. Emri i Aplikuesit | (Emri, Emri i babës, Mbiemri ose Subjekti juridik) | |
| | Numri Personal | <input type="text"/> |
| | Nr. i kartës së Identifikimit | <input type="text"/> |
| | Komuna: | |
| | Vendbanimi: | |
| | Adresa: | |
| | Telefoni: | |
| | E-mail: | |
| | Ueb faqja: | |
| Statusi Juridik: Person fizik <input type="checkbox"/> Subjekt juridik <input type="checkbox"/> | | |
| II. Emri i Projektit | _____ _____ | |
| Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga shërbyesi zyrtari regjional): | | |
| Numri unik regjistruar i projektit (NUR): _____ | | |
| III. Data: | _____ (dd/mm/vvvv) | |
| IV. Koha: | _____ (ora dhe minuta, të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë kompletuar) | |
| V. Aplikacioni është kompletuar | <input type="checkbox"/> PO | <input type="checkbox"/> JO |
| _____ | | _____ |
| (Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi i përfituesit) | | (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i zyrtarit) |

| | | |
|--|--|---|
| VI. Numri (NIF) nga Regjistri i Fermës: | | <input type="text"/> |
| VII. Për Personat Juridik Numri Regjistruar i Biznesit: | | <input type="text"/> |
| VIII. Për të gjithë Aplikuesit: | | |
| Banka | Emri i bankës: | |
| | IBAN: | |
| | Nr. i Llogarisë rrjedhëse: | <input type="text"/> |
| | Adresa: | |
| IX. Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri i cili dorëzohet në original, dhe të autorizuarit i merren të dhënat e mëposhtme | | |
| Emri _____ Emri i Babës _____ Mbiemri _____ | Numri Përsional <input type="text"/> Nr. i kartës së Identifikimit <input type="text"/> Email: _____ | |
| X. Deklaratat | | |
| Unë deklaroj se sipërfaqja e ujitur e përfshir nga sistemi i ujitjes që është paraparë të modernizohet / zgjerohet është (së paku 20 ha) – siç është prezantuar në dokumentin nr. 9 të bashkangjitur | | |
| Unë deklaroj bazuar në të dhëna ekzistuese mbi Regjistrin e Fermës për vitin 2016 fermat të cilat do të përfitojnë nga sistemi i ujitjes që është paraparë që të modernizohet/ zgjerohet dhe më dokumentit nr. 9 të bashkangjitur (të kontrollohet nga Agjencioni i Zhvillimit të Bujqësis) | 50% e këtyre sipërfaqeve të fermave është e dedikuar për hortikulturë-tokë(jo-tëpunueshme) | <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo |
| | 30% e këtyre sipërfaqeve është e dedikuar për hortikulturë-tokë(jo-tëpunueshme) | <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo |
